

**FTESE PER OFERTE**

I/E nderuar Zoteri/Zonje,

1. Ju jeni te lutur te paraqitni oferten tuaj per **“Blerje bime dhe lule”** per nevoja te Tirana Bank. *Per informacion me te detajuar ju lutem shikoni **Anekset A, B, C dhe D** bashkengjitur.*
2. Ju mund te jepni oferten Tuaj per sherbimin e lartpermendur, per te cilat do te kete procedure vleresimi dhe do te lidhet kontrate me ofertuesin/ofertuesit me te mire. {Ju mund te paraqisni oferten tuaj duke u bazuar ne FTESEN PER OFERTE}.
3. Oferta Juaj duhet te dergohet ne zarf te mbyllur. Siper zarfit duhet te shenoni emrin e kompanise dhe titullin e tenderit **“Blerje bime dhe lule”**, dhe ta dergoni ne adresen:  
**Njesia e Prokurimit**  
*Tirana Bank, Zyrat Qendrore*  
*Bulevardi “Zhan D’Ark”, Njesia Administrative nr. 2, Godina “MET Tirana Building”,*  
*Tirane*
4. **Afati i fundit i pranimit te ofertave** eshte:  
**19.05.2026**

**5. Detajet:**

**Ky tender perfshin Blerje bime dhe lule per nevojat e Tirana Bank si me poshte:**

- Bime te jashtme e te brendshme
- Materialet qe do te duhen per rikompozimin e lulishteve ne disa prej degëve te Bankes (Gjirokaster, Kavaje) dhe ne Zyrat Qendrore.
- Kompozime te ndryshme lulesh/buqetash (buqeta, kurora etj)
- Vazo te ndryshme

Specifikimet teknike, jepen ne Aneksin A bashkengjitur.

Kushtet e punes sipas Ankes C bashkengjitu.

**6. Cmimet**

Ju do te paraqisni oferten tuaj financiare (sipas Aneksit A) si me poshte:

**Kosto do te jete ne Cmim/Njesi, e detajuar per cdo ze sipas tabelës ne Aneksin A bashkengjitur, dhe duhet te perfshije:**

- Kosto per bimet/lulet te jashtme dhe te brendshme
- Kosto per vazot
- Kosto per Kompozime mbi mobilje
- Kosto per Buqeta
- Kosto per Kurora
- Kosto per Dhe/Pleh
- Kosto per Tapet Bari
- Kosto per fara, ushqim
- Kosto per puntori (Ky ze do te perdoret ne rastet kur do te kete sistemim lulishte, mbjellje bari dhe mbjellje bimesh.)



- Kosto per km jashte vijes se verdhe te Tiranës (Zeri Transport do te perdoret vetem per punimet jashte Tiranës.)
- Kosto per sulficide/pesticide etj

Vlerat e mesiperme duhet te perfshijne:

- Transportin brenda Tiranës
- TVSH, cdo takse apo tatim

**Ju duhet te paraqitni Termat e pageses ne lidhje me termat e kryerjes se sherbimit dhe levrimit te mallit. Çmimet do te mbeten te pandryshuara gjate gjithë kohezgjatjes se kontrates.**

*Pershkrim i detajuar jepet ne aneksin A dhe B. Plotesoni Aneksin A me oferten tuaj financiare.*

## 7. GARANCIA DHE AFATI LEVRIMIT:

### ➤ **Garancia:**

Produktet qe do te dorëzohen duhet te jene te reja, te paperdorura, te pa demtuara, pa difekte dhe sipas specifikave teknike te pershkruar ne Aneksin A , si dhe perputhen ne çdo aspekt me kerkesat dhe rregullat e kerkuara dhe parashikuara per pajisje te tilla.

Garancia te kerkuar nga Banka:

- Garancia per Bimet te jete minimum 6 muaj.  
Ofruar nga ju: \_\_\_\_\_
- Garancia per vazot te jete minimum 1 vit.  
Ofruar nga ju: \_\_\_\_\_

### ➤ **Afati i dorezimit te produkteve:**

Kerkuar nga Banka:

- Afati i dorezimit te produkteve:
  - Per kompozimet: ne te njejten dite qe behet kerkesa nga Banka.  
Ofruar nga ju: \_\_\_\_\_
  - Per te gjithë zerat e tjerë, dorezimi i sasise te kërkuar do te jete brenda 2 javeve, pas njoftimit me shkrim nga Banka  
Ofruar nga ju: \_\_\_\_\_

Plotesoni Aneksin B bashkangjitur.

## 8. Oferta Juaj duhet permbaje dokumentacionin e meposhtem:

### A. Dokumentacion teknik dhe ligjor:

- Fotokopje e certificates se regjistrimit si person i tatueshem nga organi perkates.
- Kopje e ekstraktit te printuar nga e-albania te Regjistrimit tregtar nga QKR brenda muajit te fundit.
- CV e kompanise.
- Klientet per punime te njejta apo te ngjashme me ate te kerkuar.
- Leter Reference per bashkepunim relevant me institucione/kompani private (te pakten dy).

**B. Formulari vigjilences:** Plotesoni, firmosni dhe vulosni formatin bashkengjitur emalit.

## 9. Detajet e kontrates:

**Kohezgjatja: 2 vite. Kontrata do të shtyhet automatikisht me të njëjtat kushte dhe për 1 (një) vit tjetër nëse Banka nuk kërkon me shkrim përfundimin e kontrates 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të afatit.**

**Draft kontrata sipas Aneksit D bashkangjitur.**

**10. Per informacione te metejshme ju mund te kontaktoni me:**

**E-mail:** [procurement@tiranabank.al](mailto:procurement@tiranabank.al)

**11. Ju lutem konfirmoni ne e-mailin e sipershenuar marrjen e kesaj ftese dhe nese ju pranoni te merrin pjese ne kete procedure prokurimi.**

**12. Ne vemendjen tuaj:** Pagesat per kompanine/te fituese per procesin e prokurimit do te behen nepermjet llogarise ne Banken Tirana dhe ne rast se nuk ka mundesi per te hapur nje llogari ne Banken Tirana, komisionet e transferimit do t'i ngarkohen kompanise.

Sinqerisht,  
**BANKA TIRANA**

**ANEKSI A – KOSTO DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Cmim/Njesi (me TVSH)	Afati i dorezimit
1	Areka 50 cm	cope		
2	Areka 70 cm	cope		
3	Areka 120 cm	cope		
4	Kendia 50 cm	cope		
5	Kendia 120 cm	cope		
6	Juka me dy koka 50 cm	cope		
7	Juka me tre koka 100 cm	cope		
8	Pashira gershet 50 cm	cope		
9	Pashira gershet 100 cm	cope		
10	Spatifilium Podi vazos 14	cope		
11	Spatifilium Podi vazos 20	cope		
12	Benjamin jeshil 70 cm	cope		
13	Benjamin jeshil 120 cm	cope		
14	Benjamin dy ngjyresh 100 cm	cope		
15	Zamiakula 30 cm	cope		
16	Zamiakula 60 cm	cope		
17	Sanseveria 60 cm	cope		
18	Bonsai me vazo dekorative Podi vazos 20	cope		
19	Bonsai me vazo dekorative Podi vazos 80	cope		
20	Bambu 100 cm	cope		
21	Kroton 50 cm	cope		
22	Kroton 100 cm	cope		
23	Sterlicja 100 cm	cope		
24	Sterlicja 200 cm	cope		
25	Tifebau 50 cm	cope		
26	Ciklamina podi I vazos 12	cope		
27	Arzale podi I vazos 12	cope		
28	Akuba podi I vazos 12	cope		
29	Petunia podi I vazos 16	cope		
30	Sulfinia podi I vazos 12	cope		
31	Mullaga podi I vazos 12	cope		
32	Viola teke	cope		
33	Petunia teke	cope		
34	Vinga podi I vazos 14	cope		
35	Gaxhanja	cope		
36	Buganville 150 cm	cope		
37	Vervena podi I vazos 12	cope		
38	Levander podi I vazos 8	cope		
39	Levander podi I vazos 12	cope		
40	Dipladenia podi I vazos 12	cope		
41	Dipladenia podi I vazos 20	cope		
42	Aechemea Primavera v.15 h.70	cope		
43	Aglaonemea S. Queen Vp17	cope		
44	Aloe Vera Vp15	cope		
45	Anthurium Vp17	cope		
46	Bromelia overig v12 h45	cope		
47	Bromelie mix Vp09	cope		
48	Cactus mix Vp 10	cope		
49	Cactus v12 h20	cope		
50	Calathea E Vp 17	cope		
51	Chamaedorea Vp 17 h55/65	cope		
52	Croton Assortito Vp 12	cope		
53	Dieffenbachia Vp16	cope		
54	Dracanea Compacta Punta v10	cope		



55	Dracanea Compacta v12 h25	cope		
56	Dracanea Deremensis 90-60-30	cope		
57	Dracanea Deremensis h120-90-60-30	cope		
58	Dracanea Janet Craigh h90-60-30	cope		
59	Dracanea Janet Lind h120-90-60-30	cope		
60	Dracanea Marginata Vp19 h60-30-15	cope		
61	Dracanea Marginata Vp24 h90-60-30-16	cope		
62	Dracanea Messangeana Vp27 h120-90-45	cope		
63	Dracanea Anita Ramificata Vp17	cope		
64	Dracanea Anita Ramificata Vp21	cope		
65	Dracanea fragrans Steudnerii v21 h105	cope		
66	Dracanea fragrans Steudnerii v24 h150	cope		
67	Echeveria gemengd v10 h15	cope		
68	Scindapsus Aureus Vp24 h120	cope		
69	Scindapsus Aureus Vp15	cope		
70	Ficus Beniam Intreciato v26	cope		
71	Ficus Ben Exotica v27 h150	cope		
72	Ficus Ginseng Bonsai gr 500 Cp 25	cope		
73	Ficus Ginseng Bonsai gr 1000 Cp 30	cope		
74	Ficus Green Vp21 h100	cope		
75	Ficus Robusta Vp17 h70	cope		
76	Ficus Abdjan Ramificata Vp21	cope		
77	Ficus Lyrata 3P Vp24	cope		
78	Guzmania Blitz v9 h25	cope		
79	Kentia Vp22 H170	cope		
80	Monstera Vp19	cope		
81	Nidularium Mayendorfii Vp09	cope		
82	Pachira Aquatica Vp21 h120-130	cope		
83	Phalenopsis Vp 12 2 Steli	cope		
84	Sanseveria Lauren Vp17	cope		
85	Sanseveria Laurentii Vp21	cope		
86	Schefflera Goldappel Vp21 H110	cope		
87	Schefflera Intreciata Mix Vp35	cope		
88	Spatiph. Martina Vp 17	cope		
89	Yucca Vp24 h90-60-30	cope		
90	Zamioculcas Vp17	cope		
91	Busha	cope		
92	Jasemin	cope		
93	Vazo per ambiente te brendshme 20x20 cm	cope		
94	Vazo per ambiente te brendshme 25x25 cm	cope		
95	Vazo per ambiente te brendshme 30x30 cm	cope		
96	Vazo per ambiente te brendshme 45x50 cm	cope		
97	Vazo kollone cilindrike 25x80 cm	cope		
98	Vazo kollone cilindrike 25x90 cm	cope		
99	Vazo kollone cilindrike 25x100 cm	cope		
100	Vazo mbi tavoline 15x25 cm	cope		
101	Vazo mbi tavoline 15x40 cm	cope		
102	Vazo mbi tavoline 20x55 cm	cope		
103	Vazo kubike, plastike gri e erret 40x40x40 cm	cope		
104	Vazo kubike, plastike gri e erret 50x50x50 cm	cope		
105	Vazo plastike 100 x 45 x 60L cm	cope		
106	Vazo plastike 70 x 35 x 35L cm	cope		
107	Pleh torf- 10 litra-200 Lek	litra		
108	Dhe I rende	litra		
109	Pesticide	litra		
110	Sulficide	litra		
111	Ushqim lulesh I lengshem-3LITRA	litra		
112	Ushqim bimesh I trashe 1 LITER	litra		



113	Tapet bari	m2		
114	FARE BARI	m2		
115	Km jashte vijes se verdhe te Tiranes Zeri Transport do te perdoret vetëm per punimet jashte Tiranes.	km		
116	Punetori/punonjës Ky ze do te perdoret ne rastet kur do te kete sistemim lulishte, mbjellje bari dhe mbjellje bimesh.	Lek/ore		
117	Kurora	cope		
118	Kompozime mbi mobilje-2,000 deri ne 5,000 Lek	cope		
119	Buqeta 1,000 deri ne 5,000 Lek	cope		
120	KAKTUS Euforia -120 cm	cope		
121	Zogu I Parajses	cope		
122	Vazo guri per ambiente te brendshme - 60x60x60cm	cope		
123	Thas pleh homos Italian - 80 litra (per kaktus)	litra		

**Cmimet duhet te perfshijne TVSH-ne si dhe te gjitha kostot, taksat ose shpenzimet e tjera te nevojshme.**

**- Oferta juaj financiare duhet te jete **ekzaktesisht** sipas tabelës së mësipërme.**

Vlerat e mësipërme të përfshijne:

- **Transportin brenda Tiranës**
- **TVSH, cdo takse apo tatim**



## ANEKSI B – KERKESA DHE DOKUMENTA TE TJERA

Ju lutem, jepni detajet tuaja per sa me poshte:

➤ **Garancia:**

Produktet qe do te dorëzohen duhet te jene te reja, te paperdorura, te pa demtuara, pa difekte dhe sipas specifikave teknike te pershkruar ne Aneksin A , si dhe perputhen ne çdo aspekt me kerkesat dhe rregullat e kerkuara dhe parashikuara per pajisje te tilla.

Garancia te kerkuar nga Banka:

- Garancia per Bimet te jete minimum 6 muaj.

Ofruar nga ju: \_\_\_\_\_

- Garancia per vazot te jete minimum 1 vit.

Ofruar nga ju: \_\_\_\_\_

➤ **Afati i dorezimit te produkteve:**

Kerkuar nga Banka:

- Afati i dorezimit te produkteve:

- Per kompozimet eshte ne te njejten dite qe behet kerkesa nga Banka.

Ofruar nga ju: \_\_\_\_\_

- Per te gjithe zerat e tjerë, dorezimi i sasise te kërkuar do te jete brenda 2 javeve, pas njoftimit me shkrim nga Banka

- **Termt e pageses:** Periudha specifike brenda se ciles Banka duhet te paguaje shumen e detyrimeve, brenda 30 diteve nga data e marrjes se Produkteve/sherbimit. **Ofruar nga Ju:** \_\_\_\_\_

- **Lista e Klienteve** me te cilet ju keni bashkepunuar specifikisht per kete produkt qe ne kerkojme ose per produkte te ngjashme: \_\_\_\_\_

- **Konfirmimi qe dispononi te gjithe Zerat e kerkuara nga Banka: Konfirmimi juaj:** \_\_\_\_\_

➤ **Dokumentacion teknik dhe ligjor:**

- Fotokopje e certificates se regjistrimit si person i tatueshem nga organi perkates.
- Kopje e ekstraktit te printuar te Regjistrimit tregtar nga QKR brenda muajit te fundit.
- CV e kompanise,
- Kontrata sherbimi te ngjashme. Klientet per punime te njejta apo te ngjashme me ate te kerkuar.
- Leter Reference per bashkepunim relevant me institucione/kompani private (te pakten dy).

- **Formulari vigjences:** Plotesoni formularin e vigjencës bashkengjitur emalit dhe firmoseni dhe vuloseni.



### **ANEKSI C – KUSHTET E PUNES**

1. Çmimet janë për njësi (ku përfshihen dhe guret dekorative) dhe do të jenë të pandryshueshme gjatë kohezgjatjes së kontratës.
2. Porositë për bime natyrore dekorative me vazo do të jepen në bazë të nevojave të Bankës.
3. “Shoqëria” është i detyruar të dorëzojë produktet në zyrat e Bankës, sipas sasisë që do të kërkojë Departamenti AM&GS, si dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në Aneksin A.
4. Dorezimi sasisë të kërkuara - brenda 2 javëve, pas njoftimit me shkrim nga Banka (Njesia FMU).
5. “Shoqëria” i garanton “Bankës” se produktet janë të reja, të papërdorura, pa defekte dhe sipas specifikave teknike të përshkruara në Aneksin A, si dhe përputhen në çdo aspekt me kërkesat dhe rregullat e kërkuara dhe parashikuara për pajisje të tilla.
6. Shoqëria garanton që produktet do të dorëzohen të pa demtuara.
7. Banka egzaminon dhe kontrollon cilësinë e produkteve brenda 48 orëve të dorëzimit. Në rast konstatimi të mospërputhjes së produkteve me termat e Aneksit A, njofton me shkrim Shoqërinë.
8. Shoqëria pas marrjes së njoftimit të mesipër, është e detyruar të zëvendësojë mallin brenda 24 orëve. Në rast se “Banka” nuk do jetë e kënaqur as nga cilësia e materialeve të reja (zëvendësuese), kontrata do të zgjidhet menjëherë.



## **ANEKSI D – DRAFT KONTRATA**

### **Neni 1**

#### **OBJEKTI I KONTRATËS**

1. Objekt i kësaj kontrate është shitja e produkteve nga “Shitesi” te “Banka” sipas specifikimeve ne **Aneksin A** te kesaj kontrate
2. “Shitesi” është i detyruar që brenda afateve të përcaktuar në këtë kontratë të dorëzojë pemët sipas porosisë të dërguar nga “Banka” dhe specifikimeve teknike të përcaktuar në Aneksin A të kësaj Kontrate.
3. Aneksi A është pjesë e pandare te kesaj kontrate.

### **Neni 2**

#### **DORËZIMI**

1. “Shitësi” do të dorëzojë produktet e specifikuar sipas Aneksit A të kësaj Kontrate, në vendodhjen dhe brenda afatit të përcaktuar në Aneksin A të kësaj Kontrate.

### **Neni 3**

#### **KOHEZGJATJA E KONTRATES**

1. Kjo kontrate hyn në fuqi ne datën \_\_.\_\_.2026 dhe është e vlefshme per dy vite.
2. Kontrata do të shtyhet automatikisht me të njëjtat kushte dhe për 1 (një) vit tjetër nëse Banka nuk kërkon me shkrim përfundimin e kontrates 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të afatit.

### **Neni 4**

#### **DETYRIME TE PERGJITHSHME TE SHITËSIT**

1. “Shitësi” merr përsipër detyrimin që produktet që do të dorëzohen të jenë të reja, të papërdorura, të pa demtuara, pa defekte dhe sipas specifikave teknike të pershkruar ne Aneksin A , si dhe perputhen ne çdo aspekt me kerkesat dhe rregullat e kerkuara dhe parashikuara per pajisje te tilla.
2. Shitesi është e detyruar t'i japë njoftim “Bankes” për çdo ngjarje, apo fakt, i cili mund të pengojë “Shitësin” për të përmbushur, në mënyrë efektive dhe të duhur sipas kërkesave të kontrates dhe akteve rregullatore perkatese. Keto ngjarje janë, por pa u kufizuar ne to, si me poshte vijon :
  - Në rastet kur produktet kanë pesuar demtime;
  - Shitesi nuk ka në dispozicion për arsye të ndryshme burimet njerezore për realizimin e kësaj kontrate;
  - si dhe çdo ngjarje apo fakt tjetër, që mund të pengojë “Shitësin” për të përmbushur kërkesat e kësaj kontrate sipas akteve rregullatore.

### **Neni 5**

#### **ÇMIMET DHE MËNYRA E PAGESËS**

1. Çmimi i produkteve të përcaktuara në nenin 1 të kësaj Kontrate jepen në Aneksin A, ku përfshihen TVSH, transporti dhe të gjitha taksat dhe tatimet e detyrueshme për t'u paguar sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.
2. Pagesa do të bëhet në llogarinë që “Shitësi” ka pranë “Banka e Tiranës” sh.a me Nr. \_\_\_\_\_ ne Lekë, 30 (dhjetë) ditë pas dorëzimit të produkteve dhe dorëzimit të faturës tek “Banka”.

### **Neni 6**

#### **GARANCIA**

1. Shitesi i garanton “Bankës” se pemët/lulet janë të shëndetshme dhe sipas specifikimeve teknike të pershkruara ne Aneksin A.
2. Shitesi i garanton “Bankën” se pemët do të jenë të shëndetshme brenda periudhës së garancisë, që nënkupton se Shitesi merr përsipër zëvendësimin brenda periudhës së garancisë me produkte të tjera me të njëjtat specifikime.
3. Afati i garancisë është sipas Aneksit B duke filluar nga data e dorëzimit të produkteve, sipas procesverbalit të dorëzimit të firmosur nga Shitesi dhe përfaqësuesi i Bankes.



#### Neni 7

#### DETYRIME TË PËRGIJTHSHËM TË BANKËS

1. Të ushtrojë kontroll mbi cilesinë e produkteve objekt i kësaj Kontrate.
2. “Banka” ka detyrimin të ekzaminojë dhe inspektojë pemët për dëmtime që mund të kenë pësuar. “Banka” duhet ti raportojë me shkrim “Shitesit” brenda 48 orëve nga dorëzimi i produkteve për çdo problematikë që rezulton nga një verifikim normal i tyre. Në këtë rast, Shitesi merr përsipër zëvendësimin e tyre.

#### Neni 8

#### KLAUZOLA KUNDER RYSHFETIT DHE KORRUPSIONIT

1. Shitesi angazhohet se nuk do të marre, nuk do të ofroje, premtaje ose do të japë ndonjë përfitim financiar ose të ndonjë lloji tjetër, që nuk është i detyrueshem sipas praktikave me të mira tregtare apo kushteve kontraktuale, drejtpërdrejt ose terthorazi për ndonjë person ose subjekt të lidhur apo jo me Banken, në këmbim që ata të veprojnë ose të mos veprojnë në kundërshtim me përmbushjen e detyrave të tyre për t’i mundësuar Shitesit lidhjen dhe/ose përmbushjen e kësaj Kontrate.

#### Neni 9

#### ANKIMIMET

1. Objekt ankimi do të jetë mosrealizimi i nënëve të kësaj kontrate.
2. Ankimimet do të behen nga Banka me shkrim brenda 5 (pese) diteve pune nga data e konstatimit të defekteve ose perfundimit të afatit të dorëzimit të pajisjeve.
3. Shitesi brenda 5 (pese) diteve pune nga marrja e njoftimit për ankim, duhet të paraqitet pranë Bankes, për të saktësuar dhe zgjidhur objektin e Ankimit në të kundërt mbetet në fuqi ankimi i Bankes. Për ankimimet sipas nenit 8 aplikohen afatet e atij neni.

#### Neni 10

#### PENALITETET

1. Në rastet e vonës në dorëzimin e pajisjeve objekt i kësaj kontrate, apo kryerjen e pageses, pas perfundimit të afateve të ankimit, si Shitesi ashtu edhe Banka janë subjekte të penalteteve të mëposhtme:
2. Për çdo ditë vonese në dorëzimin e pajisjeve, Shitesi penalizohet me të njëjten përqindje penalteti sa ajo e percaktuar në paragrafin më poshtë, mbi vlerën e pajisjeve të pa dorëzuara.
3. 11.2 Për çdo ditë vonese në pagese, Banka penalizohet sipas kamates ligjore në fuqi, në përputhje me Ligjin 48/2014 datë 24.04.2014.

#### Neni 11

#### FORCAT MADHORE

1. Shitesi nuk e humbet garancinë e realizimit të kontratës kur mosrespektimi i detyrimeve të kontratës është rezultat i një Force Madhore.
2. Do të konsiderohet Forcë Madhore çdo ngjarje që ndodh jashtë kontrollit të “Bankes” dhe nuk përbën gabim apo neglizhencë nga ana e “Bankes” dhe që nuk mund të parashikohet. Këtu bëjnë pjesë luftat, zjarret, përmbytjet, tërmetet, epidemitë, embargot.
3. Shitesi duhet që të njoftojë me shkrim “Bankën” për shfaqjen e fenomenit të Forcës Madhore.

#### Neni 12

#### TERHEQJA NGA KONTRATA

1. Secila palë mund të terhiqet nga kontrata, në qoftë se pala tjetër shkakton shkelje themelore të saj që janë:
2. a. Banka konstaton se:
  - Pajisjet e dorëzuara nuk plotësojnë kërkesat cilësore të kontraktuara dhe Shitesi nuk i zëvendëson me pajisjeve që i plotësojnë kërkesat, sipas nenit 8.
  - Shitesi vonon dorëzimin e pajisjeve tej afateve të percaktuara në kontrate.
  - Shitesi shkel detyrimet kontraktore.Në rast se kontrata zgjidhet nga Banka për shkak të përmendurës në paragrafet e 12.1.a, Shitesi është i detyruar t’i paguajë Bankes një penaltet në masën prej 5 % të vlerës së shlyer të porosise.
- b. Shitesi mund të terhiqet nga kontrata kur Banka nuk kryen në afat pagesat për pajisjet e marra në dorëzim prej tij, kur cilësia e tyre ka qenë në përputhje të plote me kushtet e percaktuara në dokumentat e

kerkuara

3. Kontrata do të quhet e zgjidhur për shkak të e përmendura në paragrafin 12.1 më sipër, nëse pala që ka shkëlur kushtet e kontratës nuk i përmbush plotësisht ato brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që ka marrë njoftimin e palës tjetër lidhur me konstatimin e ketyre shkeljeve dhe ndreqjen e tyre.
4. Në rast se Banka nuk do të jete e kënaqur nga cilësia e pajisjeve të reja (zëvendësuese) të dorëzuara, kontrata do të zgjidhet menjëherë.

#### **Neni 13**

##### **LIGJSHMËRIA DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE**

1. Kjo kontratë i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar.
2. Çdo mosmarrëveshje midis tyre, palët angazhohen se do ta zgjidhin me mirëkuptim, në rast se kjo nuk do të arrihet, atëherë kompetente për zgjidhjen e konfliktit midis tyre do të jetë Gjykata e Shkalles së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

#### **Neni 14**

##### **TË PËRGJITHSHME**

1. Ndryshimet dhe shtesat e kësaj kontrate do të jenë të vlefshme vetëm nëse shprehen me shkrim dhe firmosen nga të dyja palët dhe i bashkëngjiten kontratës në formën e Amendamentit.
2. Kjo kontratë hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqip, të nënshkruara nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve. Të dyja kopjet kanë të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore dhe secila palë do të marrë nga një kopje.

#### **Neni 15**

##### **HYRJA NË FUQI**

1. Kjo kontratë hartohet në dy kopje origjinale dhe hyn në fuqinë datën \_\_.\_\_.2026.